



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

Tabela paraprake e vlerësimit të fakteve/vlerësimit nga monitorimi

Datë: 10.01.2019

Numri i seancës për këtë çështje:
1

Ky monitorim u realizua në kuadër të projektit nr.2 "Për të rritur transparencën, gjithëpërfshirjen dhe përgjegjshmërinë në procesin e Vettingut" – projekt i mbështetur financiarisht nga Fondacioni për Shoqërinë e Hapur Shqipëri (OSFA) dhe zbatuar nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KSHH).

A. Informacioni bazë

Institucioni dhe tema:	<i>Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, seanca dëgjimore e subjektit të rivlerësimit</i>
Emri i subjektit të rivlerësimit	<i>Adrian Shega</i>
Pozicioni i punës/ qyteti nëse nuk është Tirana	<i>Ish-këshilltar ligjor, në Gjykatën e Lartë/ Kandidat për magistrat</i>
A u shty seanca dhe a ishte e arsyeshme kjo shtyrje?	<i>Seanca u shty, vetëm për dhënien e vendimit me datë 11.01.2019, ora 09:00.</i>
A u shpall vendimi apo jo (Ju lutem paraqisni arsyet në mënyrë të përmbledhur)	<i>Vendimi nuk u shpall në përfundim të seancës dëgjimore, sipas parashikimit ligjor. Konkretisht neni 55, pika 6, ligji 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve" parashikon: "Vendimi shpallet në fund të seancës dëgjimore". Trupi gjykuës nuk paraqiti asnjë arsye për këtë shtyrje.</i>

B. Aktorët që marrin pjesë në proces/seanca

Trupa gjykuese (emrat)	Genta Tafa Bungo-Kryetare, Lulzim Hamita- Anëtar dhe relator i çështjes, Valbona Sanxhaktari- Anëtare.
Monitoruesit ndërkombëtarë (emrat)	Hans Kijlstra
Mbrojtje me avokat apo mbrojtje personalisht (specifikoni)	Mbrojtja u krye personalisht nga subjekti
Monitoruesi/ja i/e KSHH:	<i>Dafina Zeneli</i>
Anëtarë të tjerë të publikut të pranishëm?	Seanca u monitorua nga një vëzhguese e Avokatit të Popullit, si dhe nga 8 anëtarë nga publiku.
Media e pranishme:	Seanca u ndoq nga disa përfaqësues të medias, kryesisht nga televizionet informative si dhe nga media të shkruara. Operatorët regjistruan vetëm hapjen e seancës dëgjimore, duke lënë më pas sallën sipas nenit 3 të Rregullores "Për marrëdhëniet me median".

C. A vendosi institucioni i vettingut ta bëjë vettingun për të tre kriteret apo bazuar vetëm në një apo dy prej tyre?	Po	Nëse po, si u justifikua ai?	Nëse po, si ka reaguar subjekti ndaj kësaj ?
	Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, vendosi të kryejë procesin e vettingut, për të terja kriteret, atë të pasurisë, figurës dhe aftësisë profesionale.	Nuk dha shpjegime.	Subjekti u pajtua me vendimin e KPK-së.

D. Përbajtja e çështjes (Vlerësimi i kriterëve)	Argumenti	kush e ka dhënë argumentin	A u diskutua? Prova? A u kalua barra e provës ?
D1. Pasuria	Lidhur me këtë kriter, relatori i çështjes paraqiti rezultatet e vlerësimit të Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave	ILDKPI	Jo, nuk u diskutua barra e provës, për shkak se nuk u konstatuan probleme në lidhje me pasurinë e subjektit.
	KPK kreu një hetim të pavarur për pasurinë e subjektit Adrian Shega. Në fund konkludoi, se subjekti disponon: 1 Automjet tip Audi A6, i vitit 2000, i blerë në janar të vitit 2014 në vlerën e 390 000 lekë. Gjatë deklarimeve të mëparshme, Shega kishte përcaktuar si burim për blerjen e mjetit, kursimet nga të ardhurat. Ndërsa në deklaratën “Vetting” në vitin 2017, kishte deklaruar si burim, përveç kursimeve edhe të ardhurat e përfituara nga shitja e një makine tip “Fiat Punto”, me vlerë 195 000 lekë. KPK nuk konstatoi probleme me burimin e të ardhurave, si për automjetin ashtu edhe për likuiditetet në vlerën e 800 000 lekëve të deklaruara, si të ardhura nga paga.	Relatori Lulzim Hamitaj	
	KPK ka kryer verifikime edhe për pasuritë e personave të lidhur me subjektin. Konkretisht, Komisioni ka verifikuar një apartament në pronësi të të atit të subjektit, me sipërfaqe 50 m2, i privatizuar në vitin 1995. Mbi shtesën e kryer në apartamentin ekzistues, subjekti ka paraqitur dokumentacionin, që tregon se është legalizuar në vitin 2015, fakt i konfirmuar edhe nga institucioni përgjegjës. Komisioni nuk ka gjetur pasaktësi në burimin e të ardhurave të investuara për shtesën e apartamentit.		
	KPK kreu verifikim edhe mbi pasaktësinë e konstatuar në deklarinim e kryer nga Shega pranë ILDKPKI për një automjet të shitur më 23 janar 2017, për të cilin ka rezultuar se nuk ka qenë e regjistruar pronësia. Komisioni vlerësoi se Shega nuk ka kryer deklarinim të pasaktë, pasi regjistrimi i mjetit, ishte detyrim i blerësit.		
	Subjekti shprehu dakordësi, lidhur me konstatimet e KPK-së.		
D2. Figura /Kontaktet me krimin e organizuar	Drejtorja e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, në lidhje me pastërtinë e figurës, e ka gjetur këshilltarin Adrian Shega të përshtatshëm për vazhdimin e detyrës.	DSIK	Jo, nuk u diskutua barra e provës, për shkak se nuk u konstatuan probleme në lidhje me pastërtinë e figurës.
	Pranë KPK-së, nuk ka pasur asnjë denoncim nga publiku ndaj subjektit Adrian Shega.	Relatori i çështjes	
	Subjekti shprehu dakordësi, lidhur me konstatimet e KPK-së.		

